

Patriakana e Rosisë Publikohen online dorëshkrime të Kishës Orthodhokse Ruse të shek. XIV



Publikohen online dorëshkrime të Kishës Orthodhokse Ruse të shek. XIV

Së fundmi është krijuar mundësia që disa dorëshkrime unike të Kishës Orthodhokse Ruse të shek. XIV, përfshirë këtu Psaltirin e Kievit apo Ungjillin e Volhynisë.

Dorëshkrimet në fjalë, të cilat kanë edhe ilustrime të shumta në miniaturë u publikuan nga Qendra e Hulumtimit të Kulturës së Lashtë Ruse “Zelo”, e cila shfrytëzoi arkivat e bibliotekës kombëtare.

Psaltiri i Kievit u krijua në qytetin me të njëjtin emër më 1397, me 303 miniatura të pikturuara në 230 faqe, si dhe shkronjat nistore e titujt të zbukuruar sipas stilit neo-

Bizantin. Shumë prej këtyre miniaturave janë interpretime të Psalmeve në frymën e interpretimit profetik të ngjarjeve të Dhiatës së Re. Ky Psaltir është i pari i këtij lloji në Rusi.

Dorëshkrimet konsiderohen një vepër e jashtëzakonshme kaligrafie dhe pikturë. Shkruesi dhe ilustruesi i tyre ishte Protodhjakoni Spiridhon, me bekimin e “Atë Mihailit” siç ai shkruan në fund.

Ungjilli i Lavrishevit u bë në shek. XIV në manastirin Lavrishev në Volhyni (që tashmë i përket territorit të Bjellrusisë). Përmban 18 miniatura me tema që nuk janë shumë tipike për ngjarjet e Ungjijve: një njëbrirësh, një imazh të Kryeengjellit Mihail dhe ilustrime që korrespondojnë me ngjarje të ndryshme biblike. Libri në fjalë ruhet në bibliotekën e princave Czartoryski në Krakov.

Qendra “Zelo” ka publikuar edhe Kronikën e Hamartolos, e cila daton në gjysmën e parë të shek. XIV. Kronika në fjalë është një vepër e Bizantit të shek. IX, ku tregohen ngjarjet historike që nga krijimi i botës. U përkthye në ruishten e vjetër që nga shek. XI.

— Burimi: orthochristian.com & radiongjallja.org